



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Datë 16.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rehabilitim i stacionit të MZSH-së, Korçë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndertimi 45210000-2

Mobilje dhe pajisje të ndryshme 39150000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

12,811,332 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) **lekë pa tvsh.**

14,862,618 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) **lekë me tvsh.**

Ky objekt është parashikuar të financohet nga të Ardhurat e Bashkisë Korçë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e përllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne **ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat**), Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”**: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, Kreu V, neni 41.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vjetet e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligji Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar Nenit 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar ku përcaktohet se : “Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël”

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % te vlerës së përlllogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë** burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vertetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Ne kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit apo marreveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta këto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anetar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
N.P - 3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S – 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S - 12	A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
N.S - 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës

ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 3	Rikonstruktion dhe mirëmbajtjeje godinash civile e industriale , veshje fasada.	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham Dyer d/alumini me mbushje element d/a. Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim muri allçi (stuko) Plintuse grez h = 10 cm Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm Çati vendi me 1 kullim HD~7m, tjegulla marselieze Shtrese me pllaka porcelanat Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Lyerje me hidromat, 2 duar Pergatitje e vendosje lende e sharruar Lyerje me hidromat, 2 duar Boje vaji siperfaqe druri Ndetim drenazhi, mbushje me zhavorr + PVC 200 mm F.V. Konstruksione metalike te thjeshta. F.V. Konstruksione metalike te thjeshta. F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm Shtrese pllaka mermeri 3 cm	A, 0-20 milionë lekë	9,650,405.67 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

		Shtrese me pllaka grez porcelanato Breza b/a monolit C 16/20 F.V. Emertim godine me germa metalike 3D dhe lartesi 500x8mm Vendosje tjegullash ekzistuese F.V. Inpiuve lllamarine Shtrese me pllaka veteshtrenguese F.V. Krevat tek+dyshek F.V. Tavolina zyre F.V. Karrige zyre F.V. Rafte metalike F.V. Rafte MDF F.V. Kuzhina F.V. Tavolina drejtuesi ne forme L(e vogel) F.V. Tavoline mbledhje e madhe (240x120x75) F.V. Tavoline kuzhine(140x90x75) F.V. Dollap garderober F.V. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartesis F.V. Komodine melamine F.V. Fikse zjarri (6-9 kg) ABC F.V. Tabela fosforeshente F.V. Detektor tymi		
N.S – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve.	Prishje mur tulle pa pastrim Prishje suvatim muri i brendshem Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallesh Heqje dyer ekzistuese Heqje dritare ekzistuese Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm. Heqje tjegullash ekzistuese	A, 0-20 milionë lekë	422,739.79 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S - 12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	F.V Kondicioner 9000 BTU mural F.V Kondicioner 18000 BTU mural F.V Kondicioner 24000 BTU mural	A, 0-20 milionë lekë	720,000.00 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

N.S - 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V. Çelesa e priza 10 A F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2 F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm2 F.V. Kutiderivacioni plastm F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m F.V. Percjelles shirit bakri tokezimi, Cu=30x3mm F.V. Kuader ndriçimi F.V. Çeles 1 polar 220V 10A F.V. Kutu suport pllaket 4 mod F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement F.V. Shirit tokezimi i galvanizuar St/Zn 40x4 ne kanale F.V Kamera Vëzhgimi Full HD, Outdoor 2 Megapixel 1080 progressive scan Outdoor tipi i sensorit: CMOS sensor F.V dvr (network video recorder) up to 8 ch with 1080p realtime live view max 80mbps incoming bandwidth up to 5mp resolution preview and playback h.264/mjpeg dual codec f.v. hdd 8 tb F.V Kanaline 2ml F.V Koka rrjeti RJ45 F.V. Kabel FTP cat6+aksesore F.V Kabell bakri FG TOR S=5X6 m/m2 F.V Kabell bakri FG TOR S=5X4 m/m2 F.V Kabell bakri FG TOR S=3X1.5 m/m2 F.V Tubo carrugato e dy shtrese veshje d=50 F.V Priza interneti F.V Kabell interneti F.V Percjelles telefonie F.V Shtize rrufepritese F.V. Mikrovale F.V. Frigorifer F.V. Televizor 50'	A, 0-20 milionë lekë	1,131,812.69 leke Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është me e vogël se 20 milion
----------	--	--	-----------------------------	--

		F.V Ndricules Led 60x60 F.V Prozhektor Led 100 watt F.V. Ndricules tip spot LED 2+18 watt F.V Aspirator F.V Pianure gatimi F.V. Monitor 19 inch		
N.S – 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	F.V. WC allafrenga F.V. Lavapjate F.V. Lavaman porcelani F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, Pn 10 F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50 F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm F.V. Saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm F.V. Saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte F.V.Grup dushi	A, 0-20 milionë lekë	397,972.27 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- **Inxhinier Ndërtimi 1 (një)**
- **Inxhinier Elektrik 1 (një)**

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I.diploma

II- kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** te perfshire ne listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- **Teknik ndërtimi 1 (një)**

Për stafin e sipërcituar të paraqitet

I.Kontrata e punes

II. Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi kërkesat 2.2.3 dhe 2.2.4

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Konkretisht:

Kërkesa per drejtuesin teknik “**Inxhinier Ndertimi**” dhe “**Inxhinier Elektrik**” eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion **ing.ndertimi** i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion **ing.elektrik** i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve elektrike, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Kërkesa per 1 teknik ndërtimi - prezenca e tij ne kantierin e ndertimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike. Tekniku i ndertimit eshte implementuesi kryesor i rekomandimeve dhe udhezimeve te inxhinierit te ndertimit per sa i perket punimeve ndertimore.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 8 persona, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve

shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Mjet transporti me kapacitet mbartes deri ne 5 ton	cope 1	ne pronesi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë :

-Ne rast se mjeti eshte ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesise, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

-Ne rast se mjeti eshte me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit te mallrave), mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi kriteret 2.2.5 dhe 2.2.6:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **fuginë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit**” dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**“

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin minimal të punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe gjithashtu edhe bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh sipas tabelës bashkelidhur dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar **numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.**

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në baze të zërthimit të grafikut të punimeve, zërthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 8 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, staf mbështetës, punonjës të specializuar/të kualifikuar dhe punëtorë të tjerë për llogaritur nga zërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se :

Sasia totale e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është 5,240.73 ore. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	5,240.73
Ditë pune (orë pune/8)	655
Specialiste+punetore për 6 muaj	5
Ing. ndërtimi	1
Ing. elektrik	1
Teknik ndërtimi	1
Numri i punëtorëve gjithsej	8

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhëzimit Nr.15, datë 24.7.2007” PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR” i ndryshuar, “ Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.”

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia	Argumentimi
Mjet transporti me kapacitet	cope 1	në pronesi ose me qera	Nevojiten për

mbartes deri ne 5 ton			transportin dhe vendosjen ne vend te materialeve ndertimore
-----------------------	--	--	---

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku perfshihen **projekti teknik, relacioni teknik, preventivi, grafiku i punimeve, specifikimet teknike, dhe planvendosja e struktures** per këtë objekt jane dorëzuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës**, pjese perberese e struktures se Bashkise Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Fondi limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM-se nr.26 date 13.04.2023 “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim”.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili eshte publikuar se bashku me dokumentat e tenderit. standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

NJESIA E PROKURIMIT